

Barra tatimore në Shqipëri, 2017

Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkan

Barra tatimore në Shqipëri dhe Kosovë, sipas qarqeve/regjioneve

Barra tatimore mes vendeve të Ballkanit dhe investimet e huaja

ALTAX

ALTAX CENTER**Studime Fiskale Shqiptare****Nr. 2017/03/01**www.al-tax.orgaltax@consultant.com

Datë 13.03.2017

Tiranë, Shqipëri

Barra tatimore në Shqipëri, 2017

Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri, 2017

Dita e Lirisë Fiskale në Kosovë, 2017 dhe Dita e Lirisë Fiskale në Ballkan 2017

Barra tatimore në Shqipëri dhe Kosovë, sipas qarqeve/regjioneve

Barra tatimore mes vendeve të Ballkanit dhe investimet e huaja

ALTAX CENTER**DITA E LIRISË FISKALË NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE BALLKAN 2017****Studime Fiskale Shqiptare****Edicioni 5^{të}**

Qendra ALTAX është një nismë studiuesish shqiptarë me synimin e një qasje të re në ndihmë të politikës fiskale dhe ekonomike shqiptare me qasje drejt politikës fiskale evropiane. Qëllimi kryesor është që të promovojë edukimin me sistemin fiskal dhe pershtatjen e tij sipas ambjentit ekonomik, të ndihmojë tatimpaguesit dhe palët e interesuara (studentët, ekspertët në terren, studiuesit) nëpërmjet ekspertizës të jenë të informuar mbi ambjentin fiskal dhe klimën ekonomike. Nga ana tjetër bashkëpunimi me akademikë dhe ekspertë fiskale ndihmon për të zgjeruar dhe për të krijuar një audiencë të plotë në ndihmë të rritjes së kapaciteteve fiskale në Shqipëri dhe Kosovë.

NE JU NDIHMOJMË TË PAGUANI TAKSAT. NE JU NDIHMOJMË TË MOS PAGUANI BAKSHISH PËR TAKSAT!www.al-tax.orgaltax@consultant.com

Mars 2017

Tiranë, Shqipëri

© **ALTAX**

Studime Fiskale Shqiptare

Mars 2017

Përgatitja dhe shpërndarja

A. Gjokutaj

Qendra ALTAX

Barra tatimore në Shqipëri, 2017

Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri, 2017

Dita e Lirisë Fiskale në Kosovë, 2017 dhe Dita e Lirisë Fiskale në Ballkan 2017

Barra tatimore në Shqipëri dhe Kosovë, sipas qarqeve/regjioneve

Barra tatimore mes vendeve të Ballkanit dhe investimet e huaja

Fjalë kyç: 2017, barra tatimore, Shqipëria, Kosova, Ballkan, tatime, taksa, qark, rajon, shkalle tatimore, liri fiskale

Dokumenti është përgatitur nga ekspertët e ALTAX, në serinë e përmbledhjeve tematike, me synimin që të kthehet në një burim diskutimi për gjithë të interesuarit, ose për ta përdorur në funksion të diskutimeve dhe analizave të politikave për shpërndarjen e barrës tatimore dhe zbatimin në praktikë në kuadër të politikës decentralizimit dhe forcimit të financave lokale.

Autorësia është e ©ALTAX.

Cilido që do të përdorë të dhëna apo pjesë nga ky botim, është i detyruar të shënojë autorësinë si referencë në publikimet që do të përdorë.

Dokumenti gjendet te faqja në internet www.al-tax.org

Nëse keni kërkesa apo pyetje dërgojini te altax@consultant.com

PËRSHKRIM

Në serinë e publikimeve që tashmë janë bërë një traditë për barrën tatimore, ashtu si edhe publikimi tjetër mbi boshllëkun tatimor, Qendra ALTAX prezanton edhe këtë vit, edicionin e pestë Barra tatimore në Shqipëri, 2017, për secilin qark në Shqipëri, regjion në Kosovë duke bërë edhe klasifikimin për barrën më të ulët dhe barrën tatimore më të lartë, sipas peshës që ato mbajnë në raport me buxhetin dhe prodhimin e brendshëm rajonal.

Me qëllimin për të parë një vlerësim më global të barrës tatimore, në studim prezantohet edhe barra tatimore në vendet e rajonit ballkanik.

Një vend të veçantë dhe për herë të parë mban barra tatimore edhe për Kosovën duke e trajtuar në nivel shteti dhe regjionesh.

Qëllimi i studimit është tërheqja e vëmendjes së politikës dhe studiuesve, medias fiskale, politikës fiskale dhe administrimit, si dhe kritikëve që mund të rezervojnë komente për vlerësimin apo kanë pyetje në lidhje me llogaritjet dhe faktet e prezantuara në dokument.

Të dhënat e përdorura për llogaritjet janë marrë nga burime statistikore zyrtare, nga financat, tatimet dhe organizata që mbajnë të baza të dhënash dhe publikojnë, si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një pjesë e të dhënave janë përpunuar dhe përdorur nga ekspertët e ALTAX për të krahasuar dhe shërbyer si referencë kryesore për prezantimin.

Shkurtime dhe përkufizime

Barrë Tatimore	Shuma totale e tatimeve të paguara, si dhe detyrimeve doganore dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, sipas bazës të të ardhurës të tatimit përkatës (tatimet mbi kapitalin, mbi punën dhe tatimet mbi konsumin) nga një grup i caktuar tatimpaguesish, industrie, rajoni, shteti etj., të krahasueshme me çfarë paguajnë grupet, industrinë, rajonet, shtetet, etj.
Ngarkesa Gjithsej e Shkallëve Tatimore	Shkallët tatimore gjithsej llogariten si ngarkesë e tatimeve, taksave dhe kontributeve të detyrueshme për tu llogaritur dhe paguar nga bizneset dhe individët. Kjo barrë tregon më së miri peshën që vendos politika fiskale e një vendi mbi rezidentët dhe jorezidentët. Tatimet në burim (të tilla si tatimi mbi pagën) ose taksat dhe tatimet e mbledhura me agjent tatimor (të tilla si TVSH, tatimi mbi shitjen) janë të përjashtuara.
Tatimet mbi të ardhurat	Tatim direkt mbi të ardhurat. Megjithëse termi përgjithësisht zbatohet për një tatim mbi individët (ku ai mund të përcaktohet si tatim mbi të ardhurat personale ose tatim mbi të ardhurat individuale), ai gjithashtu përdoret në disa vende për një tatim mbi personat juridikë, si p.sh. shoqëritë. Tatimi përgjithësisht zbatohet në bazë vjetore, d.m.th. mbi të ardhura të nxjerra në, ose lidhur me, një vit fiskal të caktuar. <i>Mund të dallohen dy sisteme kryesore të tatimit mbi të ardhurat: një sistem tatimor global dhe një sistem tatimor tabelar mbi të ardhurat. Megjithatë, edhe në sistemet e tatimit global, në pikëpamjen e përkufizimeve të ndryshme teorike të të ardhurave, shumica e vendeve i specifikojnë postet që përbëjnë të ardhura për qëllime tatimore. Shkallët e tatimit mbi të ardhurat mund të zbatohen me shkallë progresive ku shkalla e tatimit rritet me rritjen e të ardhurave ose me shkallë fikse. Mund gjithashtu të vendoset një mbipagesë.</i> <i>Shumica e vendeve vendosin tatim mbi të ardhurat për totalin e të ardhurave në shkallë botërore të rezidentëve dhe për të ardhurat nga burime brenda vendit në rastin e jorezidentëve. Disa vende, megjithatë, e kufizojnë tatimin mbi të ardhurat në të ardhurat me burim të brendshëm si për rezidentët ashtu edhe për jorezidentët sipas parimit të territorit.</i>
Tatimi mbi punën	Në këtë grup përfshihen tatimet që lidhen drejtpërdrejt me të ardhurat e krijuara nga puna. Të ardhura të tilla janë tatimi mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
Tatim mbi kapitalin	Termi përdoret për qëllime statistikore nga Kombet e Bashkuara për t'iu referuar "detyrimeve kapitale (d.m.th. ato tatime të vendosura në intervale të parregullta dhe shumë të rralla mbi vlerat e aktiveve ose pasurinë neto në pronësi të njërive institucionale) dhe tatimeve mbi transferimet e kapitalit (d.m.th. tatimet mbi vlerat e aktiveve të transferuara ndërmjet njërive institucionale si rezultat i trashëgimisë, dhurimeve me gjallje (inter vivos) (d.m.th. kur donatori është gjallë) ose transferime të tjera".
Investimet e Huaja Direkte Neto	Investimet e huaja direkte Neto janë diferenca mes hyrjeve dhe daljeve të investimeve nga vendi, për të marrë një fitim në një ndërmarrje që vepron në një ekonomi të ndryshme nga ajo e investitorit.

PËRMBAJTJA

	Parathënie	Faqe 7
	Burimi të dhënave	Faqe 9
I	Barra tatimore në Ballkan	Faqe 10
	Normat tatimore në Shqipëri, Kosovë dhe vendet e tjera të Ballkanit, 2017	Faqe 15
	Investimet e Huaja Direkte dhe ndikimi nga barra tatimore	Faqe 19
II	Barra Tatimore në Shqipëri	Faqe 22
	Efekti i politikës fiskale dhe qasja e administrimit	Faqe 25
	Pesha e të ardhurave tatimore rajonale ndaj prodhimit të brendshëm në Shqipëri	Faqe 28
	Llogaritja e barrës tatimore për Qarqet	Faqe 32
	Qarqet me barrën tatimore më të ulët	Faqe 33
	Qarqet me barrën tatimore më të lartë	Faqe 34
III	Barra Tatimore në Kosovë	Faqe 35
	Pesha e të ardhurave tatimore regjionale ndaj prodhimit të brendshëm në Kosovë	Faqe 35
	Regjionet me barrën tatimore më të ulët	Faqe 36
	Regjionet me barrën tatimore më të lartë	Faqe 37
IV	Indeksi i Lirisë Fiskale 2017	Faqe 39
	Metodologjia	Faqe 39
	Dita e Lirisë Fiskale në Ballkan, 2017	Faqe 40
	Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri, 2017	Faqe 41
	Dita e Lirisë Fiskale në Kosovë, 2017	Faqe 43
	Përmbledhje	Faqe 44
	Shtojca	Faqe 47
	Referenca	Faqe 50

Parathënie

Zhvillimi i politikave fiskale në funksion të modeleve ekonomike dhe sociale është i varur në korrektësinë e politikës, si reflektim i ambjentit ekonomik dhe social. Në rajonin e Ballkanit, ashtu si në gjithë botën nevojitet që buxhetet e qeverive të mbështeten nga sisteme tatimore që promovojnë rritjen e të ardhurave për frymë nëpërmjet stimulimit të konkurimit ekonomik.

Së pari, kjo arrihet duke miratuar një politikë që adreson situatën reale të rajonit, si dhe të secilit vend të tij. Si rrjedhojë, sistemet tatimore kanë nevojë të rakordojnë kapacitetet dhe teknologjinë me realitete të tilla si: barra tatimore, rishpërndarja e saj dhe rikuperimi i barrës të taksapaguesit, sipas peshës dhe kontributit të tyre me investimet publike. Ky ekuacion duhet të bazohet mbi parimin e se çfarë merret duhet të kthehet si kompensim.

Së dyti, është e natyrshme se politika fiskale ka ndikim direkt në buxhet, nëpërmjet politikës tatimore, doganore, lokale dhe më gjerë në aspektin social. Nisur nga ky efekt, politika fiskale duhet të nxitë reagimin e ambjentit ekonomik, ku rritja e të ardhurave të buxhetit të stimulojë zhvillimin e aktivitetit të biznesit, si rrjedhojë të nxitë rritjen ekonomike, si mund të ndodhë edhe e kundërta.

Llogaritja, matja dhe prezantimi i barrës tatimore dhe indeksi i Ditës së Lirisë Fiskale janë në edicionin e pestë të shfaqjes së tyre për ambjentin ekonomik dhe politik shqiptar dhe më gjerë. Studimi fiskal i prezantuar mbi rezultatet e metodologjisë së përdorur nga ekspertët e Qendrës ALTAX për llogaritjen e Ditës së Lirisë Fiskale, 2017 është bërë një dokument që po kizon një traditë nga Nisma ALTAX në ambientin ekonomik-fiskal shqiptar.

Matja e barrës tatimore tregon se si politika e mirë e taksave plotëson një nga qëllimet parësore, rritjen e të ardhurave duke ruajtur barazinë e tatimpaguesve në barrën që ata mbajnë. Nga njëra anë duhet të shikohet barazia lidhur me barrën që mbajnë tatimpaguesit sipas aftësisë për të paguar dhe në anën tjetër duhet të lidhet me barazinë midis tatimpaguesve që mbajnë barrën më të madhe.

Nëpërmjet llogaritjes së barrës tatimore synojmë të analizojmë efektet e sistemit të taksimit në shpërndarjen e mirëqenies ekonomike në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkan. Studimi është realizuar për të treguar nivelin e barrës tatimore nga njëri qark në tjetrin, duke komentuar për mundësitë që duhet të analizojnë politikat fiskale dhe administrimi në rritjen e të ardhurave nëpërmjet krahasimit me qarqe të

ngjashme, në funksion të financimit të shpenzimeve për investime lokale dhe qendrore dhe rritjes së mirëqenies së qytatetarëve, pa harruar se politika fiskale nëpërmjet barrës vendos mbi rishpërndarjen e të ardhurave.

Nga ana tjetër, nisur nga fakti ku secili qytetar është kontributor në buxhetin e shtetit nëpërmjet pagimit të një takse në formë direkte apo indirekte, atëherë është me interes që secili të dije se sa është barra tatimore që mban në raport me qytetarët në qarqet e tjera shqiptare, Në Kosovë si dhe në vendet e tjera të Ballkanit.

Renditja e qarqeve brenda Shqipërisë, si dhe shteteve brenda rajonit të Ballkanit sipas barrës fiskale jep mundësinë biznesit për të shqyrtuar efektshmërinë e politikave dhe nismave të qeverisë për zhvillimin ekonomik, si dhe mundet të ndikojë në momentin e analizës për alokimin e shpenzimeve publike në kuadër të transparencës së financave publike. Kjo analizë, sipas zonave administrative shërben për të parë se kush grup apo zonë gjeografike është ngarkuar më shumë, dhe nga ana tjetër një analizë më e detajuar orienton politikën për të parë se cila industri apo zonë duhet të ketë një barrë të ndryshme nga ajo që rezulton.

Objekti i krahasimit të të dhënave janë të ardhurat e paguara për llogari të buxhetit të shtetit nga rezidentët dhe jo rezidentët. Fjalori i përdorur në këtë dokument i referohet termave të ligjit të procedurave tatimore. Tatimet dhe detyrimet doganore, që përfshihen në këtë analizë janë tatimet që administrohen nga administrata tatimore qendrore (përfshirë edhe kontributet e sigurimeve sociale), taksat dhe tarifatat që administrohen nga administratat tatimore vendore, si dhe detyrimet doganore sipas rajonit ku janë arkëtuar.

Rezultatet e këtij studimi janë të bazuara mbi të ardhurat e realizuara nga rezidentët sipas rezidencës ku ata janë, pa përfshirë edhe të ardhurat tatimore nga tatimpaguesit e mëdhenj të vendit (*të përfshira sipas adresës së rezidencës*), të cilët plotësojnë afër 50% të gjithë totalit të të ardhurave tatimore për të dy nivelet e administrimit tatimor.

Të dhënat statistikore për qarqet janë objekt i analizave, sipas krahasimit të të dhënave të programeve buxhetore, niveli i realizimit dhe burime të ndryshme.

Struktura e këtij dokumenti përbëhet nga katër pjesë. Te pjesa e parë është prezantimi i të dhënave statistikore në nivel ndërkombëtar. Te Pjesa e dytë është një analizë dhe komentim i renditjes rajonale sipas barrës tatimore. Pjesa e tretë dhe e katërt sqaron metodologjinë e llogaritjes së Indeksit të Lirisë Fiskale dhe renditjen bashkë me analizat referuar renditjes.

Burimi të dhënave

Të dhënat e përdorura për Shqipërinë i përkasin realizimit të treguesve buxhetorë paraprakë të vitit 2015. Të dhënat e përdorura për vendet e tjera i përkasin vitit 2015. Ato janë marrë nga burime të publikuara nga Fondi Monetar, Banka Botërore, institute e qendra statistikore e studimore të Bashkimit Europian, si dhe nga publikime zyrtare të financave të shteteve ballkanike.

Prezantimi i të dhënave mbi Prodhimin e Brendshëm, pagimin e tatimeve dhe taksave janë bazuar mbi informacionin që gjendet në raportet e Fondit Monetar (*Country Report*), të cilat gjenden tabela, analiza dhe projeksione për të dhënat makro për vitet e fundit përfshirë edhe vitin më të fundit 2015.

Për Shqipërinë, të dhënat për prodhimin e brendshëm rajonal janë marrë nga Ministria e Financave në publikimet e borxhit publik, ndërsa të dhënat makro për tatimet dhe taksat e paguara janë nxjerrë nga përpunimi i statistikave dhe buletineve të Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave.

I.

Barra tatimore në Ballkan

Taksa dhe tatimi janë një pagesë e detyrueshme në buxhet, ku takspaguesi në këmbim nuk merr përfitim direkt. Aftësia për të paguar taksa zakonisht matet me të ardhurat e gjeneruara apo fituara.

Tatimet dhe taksat rritin në të njëjtën kohë ofertën dhe kërkesën në treg, për arsye se blerësit duhet të paguajnë një çmim më të lartë për mallrat dhe shërbimet, ndërsa shitësit duhet të shesin me një çmim më të ulët, për arsye të mos rënies së kërkesës konsumatore.

Studimi për treguesin e barrës fiskale në Ballkan përqendrohet te fakti se në cilin nga vendet tatimpaguesit paguajnë më shumë apo më pak tatime dhe detyrime të tjera fiskale, por edhe si ndikon barra tatimore te tatimpaguesit që kërkojnë të investojnë dhe paguajnë detyrimet fiskale në mënyrë vullnetare.

Tab.1 Barra tatimore në Ballkan, 2014 - 2016

RENDITJA	SHTETI	BARRA TATIMORE			%
		2016	2015	2014	
1 (1)	KOSOVË	23,5	23,8	23,3	
2 (2)	SHQIPËRI	24,4	24,1	23,8	
3 (3)	MAQEDONI	25,6	26,2	25,2	
4 (5)	BULLGARI	28,6	29,2	27,8	
5 (4)	RUMANI	29,6	28,2	27,7	
6 (7)	SERBI	36,0	35,3	33,0	
7 (6)	BOSNJË-HERCEGOVINË	37,8	33,6	37,0	
8 (9)	KROACI	38,1	38,0	36,7	
9 (8)	MALI I ZI	38,2	37,5	38,1	
10 (10)	GREQI	40,6	39,0	39,0	

Burimi: IMF, PwC, EC, MoF

Barra tatimore mesatare për Ballkanin (32.2%), në vitin 2016 ka shënuar një rritje prej 2.4 % në krahasim me një vit më përpara dhe 3.5 % krahasuar me dy vite më përpara. Rritjen më të madhe të barrës tatimore në Ballkan për 2016 krahasuar me një vit më përpara e kryeson Bosnjë-Hercegovina me 12.5 %, e pasuar nga Rumania me 5 % dhe Greqia me 4.1 %.

Shqipëria ka patur një rritje me 1.2 %, ndërsa Kosova është në grupin e vendeve me rënie të barrës tatimore me 1.3 % më pak. Ndërkohë, vendet e tjera fqinje (Serbi dhe Mali i Zi) me Shqipërinë kanë patur një rritje mesatare në 2016 të krahasueshme me një vit më përpara me 2 %. Maqedonia dhe Bullgaria kanë regjistruar ulje të barrës tatimore, respektivisht me 2.3 % dhe 2.1 % më pak.

Nga të dhënat në tabelë, për 10 vendet e Ballkanit mund të krahasohet treguesi i barrës tatimore dhe tendenca e saj nga njeri shtet në tjetrin, në mënyrë analitike.

Barra tatimore në rajonin e Ballkanit në vitin 2016 është mesatarisht sa 32.2% e PBB, ndërsa në 2015 është mesatarisht sa 31,5 përqind e PBB. Në vitin 2014 barra tatimore është 31,2 përqind. Nga njeri vit në tjetrin rezulton një rritje e barrës tatimore mesatarisht me 1.2 pikë përqind. Mesatarja e barrës tatimore e Ballkanit është dukshëm më poshtë se mesatarja e barrës tatimore të BE (40% e PBB) me 7.2 pikë përqind, por që gjithsesi me tendencë për ngushtim të kësaj difference me të paktën 0.6 pikë përqind këto tre vitet e fundit.

Nëse shikojmë shpërndarjen gjeografike në Ballkan, barra tatimore më e ulët për vitin 2016, ashtu si edhe 1-2 vite më përpara vijon në shtetet e Ballkanit Jugperëndimor dhe Qendror (Kosovë – 23,5%, Shqipëri – 24,4%, Maqedoni – 25,6%). Ndërkohë, barra tatimore më e lartë mbetet në shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Verior (Mali i Zi - 38,2%, Kroaci – 38.1%, Serbi – 36%) dhe Ballkanin Jugor (Greqi – 40.6%). Ballkani Lindor, edhe pse ka në përbërje të tij shtete (Rumania dhe Bullgaria) që tashmë janë anëtarë të Bashkimit European regjistron një barrë tatimore me të paktën 10.5 pikë përqind poshtë nivelit të saj.

Në llogaritjen e barrës tatimore sipas shkallëve tatimore nuk përfshihen skemat e përjashtimeve tatimore, si dhe politikat e përkohshme të taksimit (brenda vitit fiskal).

Por, ndërsa në listimin më lart te barrës tatimore është direkt kontributi i taksapaguesve të vendeve ballkanike në raport me PBB-në e krijuar për vitin 2016, në renditjen e vendeve ballkanike në Tabelën 2 është marrë parasysh barra tatimore, sipas politikës tatimore që kanë miratuar vendet e Ballkanit, e shprehur nëpërmjet ndryshimeve apo mosndryshimeve të normave tatimore, e shprehur si përqindje ndaj fitimit të biznesit.

Secili nga parlamentet e vendeve të Ballkanit, ja u ka prezantuar dhe ka kërkuar të ndikojë në klimën e bizneseve nëpërmjet ndryshimit të normave tatimore të një viti më përpara, duke synuar edhe në rritjen e barrës tatimore sipas planifikimeve buxhetore dhe politikave të grupeve të interesit për zhvillimet e ekonomive ballkanike. Kjo barrë e normave tatimore është shuma që llogaritet dhe miratohet për t’ja deleguar administratës fiskale qendrore dhe lokale, në mënyrë që ata ta arkëtojnë nga bizneset dhe individët, nëpërmjet punonjësve të taksave.

Nga renditja shikohet se Maqedonia dhe Kosova vijnë të ruajnë edhe në 2016 barrën më të ulët të normave tatimore në Ballkan¹. Barrën më të lartë e mbajnë edhe për 2016 dy vende anëtare të Bashkimit Europian, Rumania dhe Greqia.

Maqedonia, Kroacia, Mali i Zi dhe Greqia paraqiten me rritje të barrës së normave tatimore. Në rritjen e barrës së normave tatimore, respektivisht në Maqedoni ka ndikuar tatim fitimi, në Kroaci kanë ndikuar tatimet mbi punën, në Malin e Zi ka ndikuar tatim fitimi dhe tatimet mbi punën, në Greqi ka ndikuar tatim fitimi edhe pse ka rënie të tatimeve mbi punën.

Bosnjë-Hercegovina dhe Rumania kanë një ulje të barrës së normave tatimore të tyre. Në uljen e barrës së normave tatimore, në Bosnjë-Hercegovinë ka ndikuar ulja e tatimeve të tjera dhe në Rumani ka ndikuar ulja e tatimeve mbi punën edhe pse ka një rritje të tatimit mbi fitimin. Shqipëria ka ruajtur të njëjtën barrë të normave tatimore nisur nga fakti i mosndryshimit të politikës fiskale për normat për vitin 2016.

¹ Për vitin 2015, barra e normave tatimore është prezantuar te Shtojca.

Tab.2 **BARRA SIPAS NORMËS TATIMORE GJITHSEJ NË BALLKAN, 2016** %

RENDITJA	SHTETI	Barra e Normës Tatimore, si % e fitimit			
		TOTALI	Tatim Fitimi	Tatimet mbi punën	Tatimet e tjera
1 (1)	MAQEDONI	13.0	11.0	0.0	2.0
2 (2)	KOSOVË	15.2	9.3	5.6	0.3
3 (3)	KROACI	20.9	0.0	19.4	1.5
4 (4)	MALI I ZI	22.2	8.2	13.3	0.7
5 (5)	BOSNJË-HERCEGOVINË	22.6	7.2	13.5	1.9
6 (6)	BULLGARI	27.0	5.0	20.2	1.8
7 (7)	SHQIPËRI	36.5	14.1	18.8	3.6
8 (8)	SERBI	39.7	16.0	20.2	3.5
9 (9)	RUMANI	38.4	11.6	25.8	1.0
10 (10)	GREQI	50.7	22.4	27.7	0.6

Burimi: WB, PwC

Shqipëria, Serbia, Rumania dhe Greqia janë në vendet që kanë një barrë të normave tatimore mbi mesataren e Ballkanit.

Tab.3 **NORMA TATIMORE GJITHSEJ NË BALLKAN, 2014 - 2016** %

RENDITJA	SHTETI	NORMA TATIMORE GJITHSEJ		
		2016	2015	2014
1	MAQEDONI	13,0	12,9	7,4
2	KOSOVË	15,2	15,2	15,3
3	KROACI	20,9	20,0	18,8
4	MALI I ZI	22,2	21,6	22,3
5	BOSNJË - HERCEGOVINË	22,6	23,3	23,3
6	BULLGARI	27,0	27,0	27,0
7	SHQIPËRI	36,5	36,5	30,7
8	SERBI	39,7	39,7	38,6
9	RUMANI	38,4	42,0	43,2
10	GREQI	50,7	49,6	49,9

Burimi: WB, PwC

Nga krahasimi horizontal i normës tatimore gjithsej shihet një tendencë rajonale e rënies së tyre e krahasuar me një vit më përpara, me 0.16 pikë përqind më ulët. Ndryshimi në rënie të barrës së normës tatimore reflekton azhornimet e miratuara në legjislacionet e tyre disa nga

vendet ballkanike në lidhje me tatime të caktuara lidhur me tatimet direkte, tatimet mbi punën apo tatime të tjera.

Nëse shikojmë në politikën fiskale të vendeve ballkanike, të vetme normat tatimore nuk e plotësojnë dot objektivin e politikës fiskale të asnjërit prej vendeve. Nëse ulja e një norme tatimore të një tatimi të caktuar nuk është tatimi i fundit që paguhet për një të ardhur të realizuar, problemi i mbitaksimit nuk mund të quhet i zgjidhur. Një sistem kompleks tatimor, i zbatuar në një ekonomi e cila ka nevojë për të qenë konkurruese në tregun rajonal ka nevojë për një harmonizim të politikës fiskale me normat tatimore.

Tab. 4 **BARRA TATIMORE SIPAS PAGESAVE (ADMINISTRIMI FISKAL) vs. BARRA TATIMORE SIPAS NORMAVE (POLITIKA FISKALE)** %

RENDITJA	SHTETI	BARRA TATIMORE NË 2016, sipas:	
		Normës tatimore	Pagesës së taksave e tatimeve
1	MAQEDONI	13,0	25,6
2	KOSOVË	15,2	23,5
3	KROACI	20,9	38,1
4	MALI I ZI	22,2	38,2
5	BOSNJË-HERCEGOVINË	22,6	37,8
6	BULLGARI	27,0	28,6
7	SHQIPËRI	36,5	24,4
8	SERBI	39,7	36,0
9	RUMANI	38,4	29,6
10	GREQI	50,7	40,6

Burimi: WB, PwC

Ajo që vecohet në tabelën 4. dhe vlen për tu analizuar, është efekti i vërtetë i politikës fiskale të rritja apo ulja e barrës tatimore. Renditja sipas barrës tatimore (*produkt i administratës fiskale*) të vendeve të Ballkanit, që prezantohet më lart për vitin 2016² për një pjesë të

² Për vitin 2015, krahasimi mes barrës së normave tatimore me pagesat tatimore është te Shtojca

vendeve nuk ka të njëjtën kah rritjeje me barrën e normës tatimore gjithsej (*produkt i politikës fiskale si dhe vullnetarizmit fiskal*).

Nga krahasimi midis dy treguesve shikohet se Maqedonia, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina dhe Bullgaria kanë një barrë tatimore më të lartë se ngarkesa fiskale sipas normave tatimore. Ndërkohë, Shqipëria, Serbia, Rumania dhe Greqia kanë të kundërtën. Nëse analizojmë edhe faktorë të tjerë mund të kuptohet më qartë mungesa e përafërsisë. Nga aq sa tregon krahasimi, në vendet e grupit të Shqipërisë shihet se kanë një politikë fiskale më agresive se administrimi tatimor, i cili ka detyrimin të mbledhë në masë të plotë gjithë çfarë parashikohet në buxhet nëpërmjet programit fiskal të qeverive.

Në krahasimin mes dy treguesve të barrës që mban tatimpaguesi në vendet e Ballkanit bie në sy më shumë fakti se për vende që kanë strukturë tatimore të ngjashme (p.sh. Shqipëria me Malin e Zi apo Maqedoninë) barra e normës tatimore është ngushtësisht e lidhur me performancën e administrimit të mbledhjes së tatimeve.

Normat tatimore në Shqipëri, Kosovë dhe në Ballkan, 2017

Për vitin 2016 rajoni i Ballkanit është karakterizuar në politika fiskale që janë fokusuar në ulje të normës së tatim fitimit si dhe rritje të saj për TVSH-në. Asnjë nga vendet nuk ka synuar të bëjë një politikë fiskale që të fokusohet në reformimin e sistemit tatimor, por vetëm në disa ndryshime të vogla që kanë patur për qëllim rritjen e konsolidimit fiskal, si dhe lehtësi për grupe të caktuara të aktiviteteve të ekonomisë kombëtare.

Ndryshimet e ndodhura në normën e tatim fitimit, në rastet e uljes kanë patur për qëllim zgjerimin e bazës së tatueshme, por me objektivin për të mos u prekur të ardhurat e buxhetit dhe stabiliteti fiskal.

Norma mesatare standarte e TVSH-së në vitin 2016 për Ballkanin është 20%. Përveç Bosnjë-Hercegovinës dhe Shqipërisë, të gjithë vendet e tjera të Ballkanit aplikojnë norma të reduktura të TVSH, kryesisht për konsumin jetik, shëndetësinë, furnizimin e popullatës me energji, si dhe për librat, revistat dhe veprimtari kulturore, sportive.

Nga analiza e legjislacionit mbi ndryshimet e normave tatimore në Ballkan, vërehet se Kroacia dhe Greqia vijnë të ruajnë edhe për vitin 2016 një normë tatimore standarte të TVSH mbi mesataren e rajonit. Ndërsa Kosova, Bosnjë-Hercegovia, Maqedonia, Rumania dhe Mali i Zi kanë një normë tatimore standarte nën mesataren e rajonit. Kosova ka filluar të zbatojë një normë të reduktuar të TVSH, në fund të vitit 2015, si dhe ka rritur normën standarte me 2%, për qëllime të ruajtjes së stabilitetit fiskal të buxhetit. Po kështu, Mali i Zi dhe Serbia miratuan në 2016 normë të reduktuar të TVSH, respektivisht me 7% dhe 10%.

Greqia miratoi në vitin 2016 rritje të normës standarte të TVSH me 1%, duke u renditur si vendi i dytë me normën standarte më të lartë të TVSH në Ballkan, pas Kroacisë. Shqipëria, Bullgaria dhe Serbia zbatojnë pre disa vitesh një normë standarte mestare të TVSH në nivelin 20%.

Për tatimin mbi fitimin, normën tatimore mbi mesataren e zbatojnë Greqia, Kroacia, Shqipëria, Serbia, Rumania, ndërsa normën nën mesatare e kanë Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Bosnjë-Hercegovina.

Norma e tatimit mbi fitimin në vitin 2016 ka patur një ulje me 2% në Kroaci.

Tab.5

NORMAT TATIMORE NË BALLKAN, 2017

%

Nr.	SHTETI	TVSH	TATIM FITIMI	TATIM MBI TË ARDHURAT PERSONALE	SIGURIME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE		
					GJITHSEJ	PUNËDHËNËSI	PUNËMARRËSI
1	MAQEDONI	5, 18	10	10	27	0	27
2	KOSOVË ¹	8, 18	10	10	10	5	5
3	KROACI ²	5, 13, 25	18	12, 40	37,2	17,2	20
4	MALI I ZI ³	7, 19	9	9, 15	34,8	10,3	24,5
5	BOSNJË-HERCEGOVINË*	17	10	10	41,5	10,5	31
	BOSNJË-HERCEGOVINË**	17	10	10	23	0	23
6	BULLGARI	9, 20	10	10	30,7 - 31,4	17,8 - 18,5	12,9
7	SHQIPËRI	20	5, 15	13, 23	27,9	16,7	11,2
8	SERBI ⁴	10, 20	15	10, 25	37,8	17,9	19,9
9	RUMANI ⁵	5, 9, 19	16	16	39,25 - 49,85	22,75 - 33,35	16,5
10	GREQI ⁶	6, 13, 24	29	22, 42	40,06	24,56	15,5

Burimi: PwC, KPMG, MeF

Shënim: Ndryshimet e shkallëve tatimore, 2015 me 2014

¹ Rritje TVSH me 2% dhe futja e shkallës së reduktuar të TVSH 8%

² Ulja e tatim fitimit me 2%

³ Vendosija e shkallës së reduktuar TVSH me 7%. Rritur kontributi social me nga 1% për punëdhënësin dhe punëmarrësin

⁴ Vendosija TVSH reduktuar 10%. Vendosija e shkallës maksimale TAP me 25%

⁵ Ulje shkallës standarte të TVSH me 1%

⁶ Rritje shkallës standarte të TVSH me 1%

* Federata e Bosnjë-Hercegovinës

** Republika Srpska

3

³ Te Shtojca janë Normat tatimore të Ballkanit në 2016

Për tatimin mbi të ardhurat personale (përfshirë tatimet në burim) Greqia, Kroacia kanë normën tatimore më të lartë. Ndërsa normën tatimore më të ulët e kanë Kosova, Shqipëria⁴, Maqedonia, Bosnjë-Hercegovina.

Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Rumania dhe Greqia aplikojnë sistem progresiv të tatimit mbi të ardhurat personale, i cili mbart mbi vete ende problemin e bazës së ngushtë të këtij tatimi.

Për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, normën më të lartë e mbajnë Greqia, Serbia, Bosnja dhe Mali i Zi. Normën më të ulët e kanë Kosova, Maqedonia, Shqipëria.

Në analizën, që bazohet në treguesit për taksat e paguara në vitin 2016 sipas Tabelës 5., tendenca e pagesave të tatimeve nuk ka ruajtur të njëjtën konsistencë sipas orientimit të politikës fiskale. Maqedonia dhe Shqipëria kanë norma standarte të TVSH, si dhe akcizë që nuk futet në kategorinë e normave të ulta. Megjithë këto norma të cilat janë në nivelin mesatar, treguesi i pagesave të tatimeve indirekte (TVSH dhe akcizë) është më i ulët se vendet e tjera që kanë norma TVSH më të larta apo më të ulta se dy vendet.

Në këtë kontekst të performancës së administrimit fiskal për tatimet indirekte shihet se baza e tatimeve indirekte mbetet ende e ngushtë dhe që kërkon një rishikim të modelit të përshtatjes me ambjentin ekonomik dhe social. Nga ana tjetër, nuk shikohet që performanca jo e lartë e mbledhjes së tatimeve indirekte, të jetë kompensuar me një rritje të pagesave të tatimeve direkte, e veçanërisht të tatimit mbi të ardhurat personale.

Edhe, nëse shtrihemi në raste të tjera, nuk ka dyshim se politika fiskale ndikon në zgjedhjet ekonomike të biznesit. Por, nëse uljet e normave të tatimeve nuk harmonizohen me kapacitetin administrativ, dhe zgjerimin e bazave tatimore, atëherë krijohet një situatë buxhetore që ndikon negativisht te konsolidimi fiskal, si dhe te forcimi i vullnetarizmit në pagimin e tatimeve dhe rritjen e kulturës fiskale.

⁴ Rasti i shkallës tatimore për Shqipërinë ka spjegim për grupimin, për arsye se shkalla me 13% e tatimit mbi të ardhurat personale përfshin mbi 95% të bazës tatimore të tij.

Tab. 5.1

Pagesat sipas tipit të tatimit në % të PBB në Ballkan, 2016

in % of GDP

RENDITJA	SHTETI	Tatimet direkte	Tatimet indirekte	Tatimet e tjera	Kontributet e Sigurimeve	Tatime gjithsej
1	GREQI	9,9	16,9		13,8	40,6
2	MALI I ZI	5,8	18,5	2,2	11,7	38,2
3	KROACI	5,5	17,2	3,5	11,9	38,1
4	BOSNJË - HERCEGOVINË	3,6	18,8	0,1	15,3	37,8
5	SERBI	5,6	17,8	1,6	11,0	36,0
6	RUMANI	5,6	14,1	1,8	8,1	29,6
7	BULLGARI	5,4	15,3	1,0	6,9	28,6
8	MAQEDONI	4,1	12,4	0,4	8,7	25,6
9	SHQIPËRI	4,0	11,7	3,4	5,3	24,4
10	KOSOVË	3,9	19,6			23,5

Burimi: WB, IMF

Edhe pse studimet mbi ndryshimet e normave të tatimeve mbi konsumin dhe kapitalin janë më pak ndikuese në ekonomi, sesa ndryshimet e normave të tatimeve mbi individin dhe punën, zhvendosja e barrës tatimore nga konsumi dhe kapitali te individi dhe puna është një detyrë mjaft e vështirë për çdo qeveri.

Për vendet e Ballkanit, gjithsesi politika fiskale lidhur me normat tatimore nuk ka patur ndikimin e pritshëm në rritjen ekonomike.

Le të shikojmë rastin e malit të Zi, i cili ka aplikuar normat tatimore më të ulta në Ballkan. PBB në këtë vend për periudhën prej vitit 2008 – 2016 nuk ka shënuar një rritje të qëndrueshme, por ka mbetur në nivelin rreth 4.52 miliard Euro me ulje – ngritje gjatë këtij harku kohor.

Po kështu ka ndodhur edhe me Maqedoninë, e cila mbahet për normat tatimore më të ulta edhe madje në nivel evropian. PBB-ja e këtij vend ka mbetur në nivelet rreth 10 miliard Euro, me ulje ngritje të vlerës së shtuar kombëtare.

Nisur nga perspektiva e politikës fiskale për vendet e Ballkanit konsiderohet si e dëmshme aplikimi i një politike reformuese gjithpërfshirëse dhe që nuk mbështetet te një nivel administrimi i fortë dhe me kapacitete të ngritura. Përmirësimi i sistemit tatimor është gjithnjë një kusht i nevojshëm për funksionimin e zhvillimit ekonomik.

Investimet e Huaja Direkte dhe ndikimi nga barra tatimore

Shqipëria ka një hyrje të IHD neto (8,3% të PBB) ndër më të lartat edhe pse ka barrë tatimore ndër më të ulëtat (24.4% të PBB). Vendin e parë për thithje të investimeve të huaja në përqindje të PBB-së e mban Mali i Zi edhe për vitin 2016.

Vlerën absolute më të lartë të investimeve e ka marrë Rumania dhe Greqia, nisur edhe për shkak të strukturës, madhësisë së ekonomisë dhe kapaciteteve që u ka ofruar investitorëve të huaj. Nuk ka ndodhur e njëjta logjikë në rastin e Bullgarisë, i cili ka vlera investimesh në nivelin 1.5% të PBB-së, kryesisht për shkak të korrupsionit dhe mungesës së stabilitetit politik. Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria dhe Greqia kanë patur IHD neto (1.5% - 1.6% të PBB) më të ulta në Ballkan.

Tab.6 **INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NETO NË BALLKAN, 2014 - 2016** si % e PBB

Nr.	SHTETI	INVESTIMET E HUAJA DIREKTE		
		2016	2015	2014
1 (1)	MALI I ZI	8.4	10.8	8.9
2 (2)	SHQIPËRI	8.3	8.7	8.3
3 (5)	SERBI	5.9	4.6	3.3
4 (4)	KOSOVË	3.9	4.9	5.3
5 (3)	KROACI	3.5	6.9	1.0
6 (8)	RUMANI	2.4	1.9	1.6
7 (10)	MAQEDONI	2.1	0.5	3.0
8 (6)	BOSNJË-HERCEGOVINË	1.5	2.7	1.9
8 (7)	BULLGARI	1.5	3.5	2.8
9 (9)	GREQI	1.6	0.7	1.1

Burimi: WB, TE, BSH,

Investimet e huaja direkte mesatare në Ballkan janë sa 3% e PBB-së në nivel rajoni.

Kur analizojmë efektin e barrës tatimore sipas statistikave të IHD neto në përqindje të prodhimit të brendshëm, vërehet se vendet me IHD më të lartë nuk kanë të njëjtën ecure me barrën tatimore.

Arsyeja e mospërkimit të barrës tatimore, shkallës tatimore dhe investimeve të huaja është pasqyrimi më i mirë i rolit që ka në radhë të parë klima për investime në një vend të caktuar. Politika fiskale ka efektin për të thithur investimet, por kjo ndodh pasi kushtet dhe rregullat për tregun perceptohen nga investitorët sipas indekseve për investim me situata pozitive dhe mbi nivelet mesatare të tyre.

Nga ana tjetër, nevoja për sisteme të zhvilluara të tregut financiar, kapaciteteve të tregut të punës bashkë me nivelin e korrupsionit kanë një tjetër efekt me ndikim në thithjen e investimeve dhe zhvillimin e tregut të brendshëm.

Perceptimi se normat e ulta të tatimeve tërheqin IHD ka ndikuar jo pak politikëbërjen në Ballkan në dekadën e fundit. Në teori, nëse një vend aplikon norma të ulta të tatimit mbi fitimin dhe përgjithësisht mbi kapitalin bëhet më tërheqës për tu zhvendosur fitimet e kompanive investitore, pasi ndikon mbi dividendin që mbetet si fitim pas tatimit. Riatdhesimi i fitimit të kompanitë që kanë hapur këto degë të tyre në vendet me norma të ulëta tatimore ndikon edhe në instalimet e shumëkombsheve.

Është pikërisht, kjo politikë e normave të ulta tatimore që është kthyer në një konkurim të fortë midis vendeve të Ballkanit, duke u diktuar të zbatojnë edhe politikat për shmangien e taksimeve të dyfishta dhe adoptimin e parimeve të OECD mbi transferimin e fitimit nëpërmjet çmimit.

Shqipëria dhe Kosova janë të krahasueshme në politikat e tyre me vendet e tjera të Ballkanit, por që gjithsesi kanë problematika të korrupsionit dhe kapaciteteve jo të përshtatshme me mekanizmat që përdoren në sisteme me tatime të ulta.

Por, gjithsesi nga kryqëzimi i treguesve të investimeve, me normat tatimore mbetet e paqartë nëse duhet ulur realisht një normë tatimore me qëllimin për të tërhequr vëmendjen e investitorëve.

Nëse nisemi nga logjika e vendeve të zhvilluara ekonomike, si dhe atyre që po ndjekin ritme të përshpejtuara zhvillimi, mund të vërehet se nëse ekonomia mbështetet mbi një infrastrukturë të zhvilluar, shërbime publike efektive, zhvillohet mbi një treg relativisht të

madh, atëherë konkurenca e normave tatimore dhe barrës tatimore fiton avantazhe vetëm kur garantohen apo egzistojnë këto kushte.

Kjo ndodh në numrin më të amdh të vendeve anëtare të OECD, që kanë një barrë të lartë tatimore, por dhe janë shumë efektivë në thithjen e investimeve të huaja.

Një barrë e ulët tatimore nuk mund të kompensojë një ambjent jo tërheqës për investorët. Kjo ndodh për arsyen se taksat janë vetëm njëri nga elementet që edhe në kushtet e një oferte me taksa të ulëta nuk arrin dot të kompensojë infrastrukturën e dobët, aksesin e dobët në treg si dhe kushte të tjera mbi të cilat bazohet në vendimarrjen e tij një investor.

Qeveritë ballkanike u janë përgjigjur këtyre presioneve të konkurrencës në mënyrë ta ndryshme. Shumë nga vendet kanë ulur normat e tatimit mbi fitimin, si rruga më e shkurtër dhe e monitorueshme lehtësisht për të arritur objektivat për investimet.

Gjithsesi, uljet e normave tatimore kanë tendencën të jenë me kosto të lartë për buxhetin, pasi të ardhurat që i hiqen buxhetit nga politika e uljes së normave të tatimeve në fakt prish konkurrencën e ndershme në vend, por kthehet edhe në një barrë të shtuar për segmente dhe grupe të caktuara të tatimpaguesve.

Nga ana tjetër, ulja e normave tatimore kthehet në një kulturë për qytetarët për ti bërë presion qeverive për mbajtjen e një politike të tillë në mënyrë permanente, pa patur efekt në zgjerim të bazës dhe shpërndarjen e barrës në mënyrë të barabartë.

Pas një reagimi të duhur mbi indeksat e treguesve më lart, në përputhje me planifikimin për thithjen e investimeve të huaja vlen të hartohet politika fiskale që përshtat shkallët e taksimit të kapitalit dhe punës sipas nivelit të tregut dhe vizionit për tregun e ardhëm.

II.

Barra Tatimore në Shqipëri

Barra tatimore është një tregues që merr një kuptim të veçantë për Shqipërinë, nisur nga konteksti ekonomik dhe social me luhatje të vazhdueshme, si dhe nga mungesa e stabilitetit të sistemit fiskal dhe social.

Në këtë kapitull do t'i jepet përgjigje pyetjes se cili qark paguan më shumë apo më pak tatime në buxhet⁵. Paraprakisht do të prezantojmë ndikimet e faktorëve që e bëjnë vlerësimin të mundshëm.

Kur marrim në konsideratë faktorët ndikuesë, matja e barrës tatimore nuk është matje e shtrirjes së efektit buxhetor të qeverisë apo administratës publike (përbërja e saj). Nga ana tjetër nuk është as matja e gjithë detyrimeve që mbart një tatimpagues në funksion të të ardhurave që ai realizon brenda një viti (pagesa për institucione jofiskale).

Përpara se të trajtohet niveli i barrës tatimore sipas rajoneve (qarkut) të Shqipërisë do të shikohen elementët përbërës që përfaqësojnë këtë barrë në buxhetin e shtetit.

Të ardhurat tatimore në buxhetin e vitit 2016 zënë 90.9% të gjithë totalit. Ndërkaq të ardhurat jotatimore zënë 5.9% të totalit të të ardhurave të buxhetit. Pjesën tjetër të të ardhurave të buxhetit e zënë ndihmat me 3.2% të totalit.

⁵ e shprehur si përqindje e tatimeve dhe taksave e tarifave të paguara ndaj PBB-së

Të ardhurat tatimore (përfshihen të ardhurat në tabelën më poshtë), që janë pjesa kryesore

Struktura të ardhurave tatimore

	%	
Të ardhurat tatimore	2015	2016
Tatimet dhe Doganat	76.1	74.9
Pushteti Vendor	3.4	4.1
Sigurimi Shoqëror dhe Shëndetësor	20.5	21.1

e buxhetit dhe për vitin 2016 dhe 2015, respektivisht janë sa 24,4% dhe 24.1% e PBB-së.

Burimi: MoF

Në këtë barrë tatimore, të

ardhurat nga tatimet dhe doganat në vitin 2016 kanë zënë një pjesë sa 74.9% e totalit të të ardhurave tatimore, me një rënie të peshës prej 1.2 përqind. Këtë rënie të peshës së të ardhurave qendrore e kanë rimarrë të ardhurat vendore me një peshë ndaj totalit me 4.1%, ku rritja e tyre me një vit më parë është 0.7%. Po kështu edhe kontributet e sigurimeve, në vitin 2016 zënë një peshë prej 21.1%. Kjo rritje prej 0.6% për këtë zë vjen nga formalizimi i punës, si dhe ndryshimet ligjore që erdhën nga heqja e tavanit të të ardhurave nga puna për efekt të llogaritjes së sigurimeve shëndetësore.

Të ardhurat e mbledhura, që përkojnë me veprimtarinë e administratës tatimore qendrore dhe doganore përbëjnë pjesën kryesore të barrës tatimore, respektivisht për 2015 dhe 2016 sa 17,9% dhe 18,3% e PBB-së. Kjo rritje i dedikohet kryesisht rritjes së pagesave të tatimit mbi fitimin dhe tatime të tjera mbi kapitalin, taksave nacionale dhe rritjes së pagesave të akcizës.

Barra tatimore, që vjen nga administrimi tatimor vendor (administratat fiskale lokale) në vitet 2015 dhe 2016 është respektivisht sa 0.8% dhe 1% e PBB-së. Në vitin 2016, nisur edhe nga një administrim i mirë i territorit, veçanërisht në Tiranë, si dhe ndikimi nga taksa e re mbi truallin u arrit në nivele performimi më të mirë se viti i mëparshëm, por ende nën kapacitetet e performancës standarte që kanë administratat lokale në vendet e rajonit.

Barra e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitet 2015 dhe 2016 ka një peshë të konsiderueshme të barrës tatimore, respektivisht sipas viteve më lart ajo është sa 4.8% dhe 5,1% e PBB-së.

Struktura e tatimeve

Tipi tatimit	2015	2016
Tatime indirekte	65	65
Tatime direkte	35	35

Burimi: MoF

Pesha e tatimeve direkte dhe indirekte në barrën tatimore ka mbetur e pandryshuar në vitin 2016 nëse e krahasojmë me një

vit më përpara.

Kjo tregon ende një barrë tatimore që mbahet nga konsumatori shqiptar, dhe jo nga ekonomia. Nga ana tjetër, ajo pasqyron nevojën e modifikimit të politikës për zhvendosjen e barrës tatimore nga konsumi të kapitali, ku kryesisht duhet të jenë individët e pasur dhe bizneset e mëdha ata që duhet të mbajnë peshën kryesore në këtë drejtim.

Në një renditje analitike, në tabelat më poshtë mund të shihet pesha sipas tipit të tatimit në raport me totalin e barrës.

PESHA SIPAS STRUKTURËS	2015	2016	% Ndryshimi
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	51.5%	50.9%	-0.7%
nga administrata tatimore	14.7%	15.5%	0.8%
nga administrata doganore	36.9%	35.4%	-1.5%
minus Rimbursimi TVSH	3.0%	3.2%	0.2%
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (Neto)	48.5%	47.6%	-0.9%
Tatimi mbi Fitimin	10%	11%	0.9%
Akcizat	15%	15%	0.1%
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	11%	11%	-0.1%
Taksa Nacionale dhe të tjera	13%	13%	0.0%
Taksa Doganore	2%	2%	0.0%

Në shikimin analitik të peshës së tatimeve kryesore në raport me totalin e të ardhurave tatimore, shihet se nga krahasimi midis secilit tatim për dy vitet 2016 dhe 2015, pesha e TVSH neto⁶ është 0.9% më pak.

Kjo rënie është ndikuar kryesisht nga të ardhurat në rënie të TVSH-së nga importet. Por edhe për administratën tatimore qendrore, në rastin e një zbatimi të plotë të kërkesave për rimbursime do të rezultonte një rënie e njëjtë e TVSH si te doganat.

Rritje në 2016 ka tatimi mbi fitimin me 0,9% dhe akciza me 0.1%. Tatimi mbi të ardhurat personale ka shënuar një rënie me 0,1% më pak se një vit më përpara, kryesisht nga

⁶ TVSH neto është diferenca midis TVSH së arkëtuar minus rimbursimin e TVSH

performanca e dobët e administratës. Ndërkohë, që duket se nuk kanë patur ndryshime taksat nacionale dhe doganore.

Të ardhurat e pushtetit vendor shënojnë një rritje në 2016 vetëm nga taksat lokale me 15.6%.

PESHA SIPAS ZERAVE	2015	2016	Ndryshimi	ne %	Taksa e pasurisë dhe taksa mbi biznesin e vogël kanë patur një rënie të peshës së tyre me 2.2% dhe 13.4% më pak në
Taksë mbi Pasurinë(ndertesat dhe trualli)	34%	31%	-2.2%		
Taksë mbi Biznesin e vogël	17%	4%	-13.4%		
Taksa Lokale	49%	65%	15.6%		

2016.

Këto treguesë vlejné për transparencë në lidhje me peshën që mbajnë konsumatorët dhe investitorët duke kuptuar se tendenca në rënie e peshës së tatimeve indirekte (presioni mbi çmimet e konsumit) dhe tendenca në rritje e tatimeve direkte (ndikimi mbi fitimin korporativ dhe të ardhurat personale) pasqyrojnë efektet e politikës fiskale të qeverisë, e cila synon një rishpërndarje të të ardhurave duke përfutur më tepër tatime nga fitimi mbi kapitalet.

Efekti i politikës fiskale dhe qasja e administrimit

Rritja e peshës së barrës së tatimit mbi vlerën e punës (tatimi mbi të ardhurat personale) dhe ndaj kapitalit (tatimi mbi fitimin) janë efekti që ka prurë tatimi progresiv dhe lehtësimi në tërësi i pagave për punëtorët e pakualifikuar dhe me paga të ulëta, të cilat kanë ndikim si në rritjen e bazës së tatimit, po ashtu edhe në rritjen e fitimit nga bizneset.

Në vitin 2016, si viti i dytë i zbatimit të ligjit të ri i TVSH-së ka qenë një periudhë në pritje të konsolidimit të politikës së freskuar për këtë tatim që mban 32% të të ardhurave të buxhetit.

Edhe në Kosovë nisur nga fakti se ligji i TVSH pësoi ndryshim të normës dhe një shkallëzim për mallrat bazë mbetet ende të shikohen efektet në formalizimin e ekonomisë dhe rritjen e produktivitetit të TVSH-së.

Viti 2016 ishte viti e tretë në Shqipëri, i zbatimit të politikës fiskale të progresivitetit të normave tatimore⁷ në lidhje me tatimin e kapitaleve dhe të punës. Nga analiza e të ardhurave arrijmë të krahasojmë se efektet e saj në performancën buxhetore mbeten poshtë rezervave të këtij tatimi kyç duke kuptuar edhe diferencat që mbeten midis politikës dhe administrimit.

Niveli i ulët i barrës tatimore jo gjithmonë vjen nga normat e ulta, por në rastin e Ballkanit ndikimi i normave të ulta përkthehet me një rrjedhojë direkte të një barre të ulët. Arsyeja qëndron te niveli i informalitetit, korrupsionit dhe sistemeve tatimore ende të paharmonizuara me ekonominë dhe tregun. Por edhe lehtësirat fiskale dhe përjashtimet tatimore kanë një ndikim deri në 3-4% të PBB-së në rajon duke ulur de facto barrën tatimore të secilit vend që i zbaton këto politika lehtësuese dhe përjashtuese.

Efekti i ndryshimeve në ligjin e tatimit mbi të ardhurat në vendet e Ballkanit ka patur një efekt më të dobët te taksimi, në raport me rritjen e nivelit nominal të të ardhurave.

Më shumë punë duhet të bëhet për të shqyrtuar efektin e ndryshimeve të prejardhura nga politika tatimore në Ballkan. Më shumë duhet që të përshtatet barra tatimore me zhvillimin ekonomik të secilit vend si dhe atë rajonale duke përshtatur politikën në mënyrën më të natyrshme me objektivat ekonomikë.

Një nivel i lartë i barrës tatimore do të justifikohet vetëm për ato vende me nivel të lartë teknologjie, produktivitet të lartë të punës dhe një kulturë të zhvilluar për pagimin vullnetar të taksave.

Në vendet e Ballkanit me nivel të ulët të zhvillimit ekonomik, ku të ardhurat për frymë janë ndër nivelet e ulta ose mesatare të nivelit europian të të ardhurave për frymë, ngadalësimi i rritjes së barrës tatimore ka efekt negativ në rritjen e PBB-së. Ulja e barrës tatimore do të rezultonte në uljen e PBB-së, pasi nxitja që japin taksat për ekonominë e vendeve ballkanike konsiderohen se kanë ende një ndikim nxitës dhe formatues të sistemeve tatimore të këtyre vendeve.

⁷ Taksa e sheshtë mbi tatimin e fitimit dhe tatimit mbi të ardhurat personale u zëvendësua në 2014 me tatimin progresiv.

Ofertat populiste të politikanëve ballkanikë për ulje të normave tatimore duke deklaruar se bëhet për qëllime të rritjes së ekonomisë dhe nxitjes së investimeve dhe po ashtu edhe punësimit, kursimeve dhe rritjes së mirëqenies (të ardhurave për frymë) kanë rezultuar në realitetin ekonomik dhe social si jo të vërteta dhe me efekt të dobët në funksion të objektivave të shpallura. Këto oferta politike pa bazë dhe mbështetje në realitetin ekonomik të vendeve ballkanike kanë krijuar efekte që kanë pakësuar produktivitetin ekonomik dhe investimet kapitale duke minuar besimin e investorëve për investime të reja. Në këtë mënyrë, uljet e normave tatimore, të konceptuara pa lidhje me politikat dhe reformat e tjera të ndërmarra apo të filluara nga qeveritë kanë ndikuar përgjithësisht në rritjen e deficiteve buxhetore.

Edhe pse rritja e barrës tatimore duket si rruga më e lehtë për ngushtimin e deficitit buxhetor, faktikisht nuk është e vërtetë. Duke konsideruar karakteristikat rajonale dhe objektivat specifike të secilit vend është mëse e natyrshme aplikimi i skemave tatimore të diferencuara midis vendeve, si dhe të normave të tatim fitimit dhe tatimit mbi kapitalin, sipas objektivave buxhetore.

Por, e keqja tjetër e politikave fiskale është mostrajtimi njëkohësisht i barrës tatimore me balancën makroekonomike dhe punësimin. Nga ky nënvleftësim i njërit element në dëm të tjetrit harrohet fakti më i madh që duhet të konsiderojë një qeverisje e aftë: shprehjen e qartë të vullnetit për ti dhënë të njëjtin prioritet, si fuqizimit të buxhetit, po ashtu edhe fitimeve dhe kursimeve të biznesit dhe individëve.

Nëse të ardhurat e buxhetit do të planifikohen të rriten bashkë me investime private (të huaja dhe vendase) në të njëjtën kohë, atëherë presioni buxhetor do të jetë më pak i ndjeshëm dhe në anën tjetër investorët do të ndihen më të relaksuar lidhur me kthimin e investimeve të tyre.

Pesha e të ardhurave tatimore rajonale ndaj prodhimit të brendshëm në Shqipëri

Raporti që kanë taksat e paguara të një vendi apo njësie territoriale brenda vendit në raport me PBB-në e tij është një tregues që vlen për të parë se sa është kontributi real i takspaguesve, si dhe për të planifikuar nga ana tjetër kthimin mbrapsht të këtyre pagesave në formën e shpenzimeve që bëhet nga buxheti.

Në tabelën 6., që përmban llogaritjen e të ardhurave tatimore, që mblidhen nga administrata qendrore dhe vendore prezantohet një renditje sipas peshës së të ardhurave që arkëtoi dhe kontribuoi në buxhet secili qark në Shqipëri në raport me prodhimin e brendshëm bruto të Shqipërisë në vitin 2016.

Tab.6 Barra tatimore ndaj PBB të Shqipërisë, 2015 - 2016 %

RENDITJA	QARKU	Te ardhurat e mbledhura ndaj PBB	
		2016	2015
1 (1)	Tiranë	12,1	10,4
2 (2)	Durrës	2,4	2,6
3 (3)	Fier	2,3	2,2
4 (4)	Elbasan	1,6	1,7
5 (5)	Vlorë	1,5	1,7
6 (7)	Shkodër	1,0	1,0
7 (6)	Korçë	1,1	1,5
8 (9)	Lezhë	0,7	0,7
9 (8)	Gjirokastrë	0,6	0,7
10 (12)	Berat	0,6	0,4
11 (10)	Dibër	0,5	0,7
12 (11)	Kukës	0,3	0,5
TOTALI		24,4	24,1

Burimi: INSTAT, MoF, Pushteti Vendor

Kjo renditje nuk synon të pasqyrojë barrën tatimore, por vetëm tregon një renditje të peshës së të ardhurave që mblidhen nga secili qark në PBB-në e vendit.

Pesha e barrës tatimore rajonale (tatimet dhe taksat qendrore dhe vendore) ndaj prodhimit të brendshëm, përfshin llogaritjen e tatimeve të paguara në buxhetin e shtetit nga secili qark ndaj PBB-së së vendit. Në këtë kategori të ardhurash përfshihen barra tatimore që mbajnë tatimpaguesit për llogari të administratës tatimore qendrore (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve), si dhe administratat tatimore vendore (Bashkitë dhe Komunat).

Barra tatimore për gjithë qarqet në vitin 2016 peshon sa 24.4% e PBB-së. Peshën kryesore e mban qarku Tiranës me një barrë tatimore që është sa 12,1% e PBB-së, e ndjekur nga Durrësi dhe Fieri me një peshë respektive sa 2.4% dhe 2.3% e PBB-së. Më shumë se gjysma e barrës tatimore që është derdhur në buxhet nga administrata tatimore dhe doganore në formën e taksave dhe tatimeve i përket zonës së Tiranës dhe Durrësit.

Nga analiza e renditjes së peshës së të ardhurave në PBB me peshën e banorëve ndaj popullsisë së vendit shikohet, se përveç tre qarqeve më të mëdhenj të pozicionuar në tre vendet e para, gjithë qarqet e tjera kanë një peshë të ardhurash më të vogël se pesha e banorëve. Kjo mospërputhje spjegohet, me përqëndrimin e konsumit dhe industrisë e tregtisë me shumicë në këto qarqe të mëdha.

Nga ana tjetër, një administrim fiskal lokal më i mirë mund të justifikojë ngushtimin e diferencave midis konsumit dhe shpërndarjes së popullsisë dhe bizneseve në qark.

Ndryshimet ligjore të fundvitit 2015 në sistemin fiskal, nga njëra anë synuan të lehtësonin biznesin e vogël dhe të vetëpunësuarit dhe nga ana tjetër, tentuan të normalizojnë situatën në shumë sektorë të ekonomisë lokale.

Këto ndryshime, njëkohësisht rritën të ardhurat në disa bashki kryesore, p.sh. Bashkia Tiranë, duke bërë të mundur ofrimin e më shumë shërbimeve me një cilësi dhe sasi më të lartë.

Në politikat fiskale lehtësuese në drejtim të barrës së taksave lokale ishte “Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin” për biznesin e vogël, i cili u shfuqizua, duke lehtësuar kështu biznesin e vogël dhe sidomos të vetëpunësuarit. Kështu, biznesi me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë pagoi zero taksa mbi qarkullimin. Ndërsa biznesi me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë lek pagoi 5% të fitimit të thjeshtuar të tatueshëm.

Më shumë se gjysma e taksave në të gjitha qarqet u mbledhën nga bashkia kryesore e secilit qark.

Taksa mbi pasuritë e paluajtshme, për shtëpitë e banimit mbeti në më të shumtën e bashkive në të njëjtin nivel si më parë, me përjashtimin të disa bashkive që aplikuan ulje të saj. Për herë të parë në vitin 2016 u vendos një taksë e re mbi truallin, e cila edhe pse teorikisht konsiderohet një barrë e shtuar, në fakt ajo ka filluar të aplikohet në vlera shumë të ulëta dhe ndikimi i saj nuk ishte me shumë se 0.11% e PBB për vitin 2016.

P.sh. individët në Tiranë paguan vetëm 0.56 lek/m² në vit ndërsa bizneset vetëm 20 lekë/m² në vit.

Pesha specifike e taksave lokale që zënë qarqet e vendit⁸, ka specifikat që përfshijnë numrin e tatimpaguesve që mbajnë barrën tatimore, karakteristikat industriale, përbërjet gjinore, strukturën e popullsisë, arsimimin, burimet natyrore nëntokë dhe mbitokë, pasuritë individuale të trashëguara dhe aktivet e krijuara në mbi dy dekada, si dhe elementë të ambjentit dhe investimeve me fonde publike dhe private duke përfshirë edhe planet e zhvillimit zonal.

Këto raporte orientojnë edhe shpërndarjen e segmentimit të tatimpaguesve, sipas madhësisë që ata kanë (mikro, të vegjël, të mesëm, apo të mëdhenj). Nga të dhënat e raporteve, mund të shihet se barra tatimore në rajone mbahet nga baza e tatimpaguesve që përfshihen në kategoritë e bizneseve mikro (vetëpunësimet) dhe të vegjël, sesa nga baza e tatimpaguesve që përfshihen në kategoritë e bizneseve të mesme dhe të mëdhenj.

Një faktor ndikues lidhet me shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve për konsum, të cilat kanë një prirje të konsumohen jashtë zonës ku krijohen apo prodhohen drejt eksportit apo në zonat me dendësi populsi.

Shembull kuptimplotë është rasti i zonave ku nxirren pasuritë natyrore nëntokësore.

Zhvendosja e tyre drejt eksportit apo zonave me popullsi të dendur urbane bën në të njëjtën kohë edhe zhvendosje të barrës nga njëra zonë e qarkut në tjetrën. Nga ana tjetër, barra tatimore që mbajnë jorezidentët, edhe pse ka një peshë specifike jo më shumë se 4% në totalin e barrës tatimore ka një ndikim në zonat ku ata janë vendosur dhe krijojnë të ardhura brenda territorit të Shqipërisë.

⁸ Lista e plotë e taksave vendore gjendet te Shtojca.

Llogaritja e barrës tatimore për qarqet

Llogaritja

Barra tatimore për qarqet e vendit është bazuar mbi të dhënat mbi bazë qarku. Në të ardhurat që llogariten si barrë tatimore përfshihen detyrimet e paguara nga biznesi i regjistruar në drejtoritë rajonale tatimore, si dhe për ato pagesa të taksave dhe tarifave vendore që bëjnë pjesë në të ardhurat tatimore, sipas përfshirjes që bëhet në buletinet fiskale. Të dhënat statistikore janë marrë nga buletini informativ i Instat, nga të dhëna të tjera të publikuara nga administratat tatimore, doganore dhe vendimet e raportet vjetore të miratuara nga pushteti lokal, të kryqëzuara me të dhënat e publikimeve të Fondit Monetar, Bankës Botërore, si dhe të studimeve të kryera për Shqipërinë nga projekte vendore, të cilat kanë shërbyer si referencë për llogaritjen e barrës tatimore dhe treguesve të tjerë krahasuesë.

Për llogaritjen e prodhimit të brendshëm të qarkut për vitin 2016 janë vlerësuar nga ekspertët tanë edhe botimi i Institutit të Statistikave si dhe tendenca rajonale e strukturës së prodhimit të brendshëm në tre vitet e mëparshme ndaj mesatares. Për llogaritjen e detyrimeve doganore janë llogaritur arkëtimet e degëve doganore dhe alokimi sipas mallrave dhe pikave të hyrjes së tyre kryqëzuar me konsumin dhe aktivitetet në qark.

Ndërsa tatimet e paguara nga shoqëritë më të mëdha janë llogaritur si një barrë tatimore që i përket Tiranës dhe vendodhjes së tyre në disa nga qarqet ku kanë vendndodhjet e tyre të biznesit në qytete kryesore si: Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër dhe Gjirokastër. Pas përcaktimit të tatimeve të paguara sipas qareve është bërë raporti me prodhimin e brendshëm sipas qarkut përkatës duke rezultuar në raportet e paraqitura në analizë.

Parashikimi i të ardhurave për bashkitë ashtu si për Bashkinë e Tiranës është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, informacion i përfituar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në vite si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore për to.

Në këtë përlllogaritje gabimi shkon deri në $\pm 3\%$.

Qarqet me barrën tatimore më të ulët

Barra tatimore më e ulët është në qarkun e Kukësit me një tregues të barrës në nivelin 14,1%. Ky nivel i barrës në këte qark, që rezulton sipas raportit të tatimeve të paguara në vitin 2016 ndaj prodhimit të brendshëm të qarkut të vitit 2016 është rrjedhojë e lehtësimit të barrës tatimore me të paktën tre vende më lart në krahasim me vitin e mëparshëm. Qarku i Dibrës është ngjitur 6 vende më lart në krahasim me një vit më përpara për shkak të një barre më të ulët tatimore me 12.1 % më pak.

Qarku i Beratit, i cili në vitin e mëparshëm ishte me barrën më të ulët në Shqipëri ka patur një pozicionim me tre vende më poshtë për shkak të rritjes së barrës me 4.8 % më shumë duke mbajtur reflektuar një barrë tatimore sa 17.2% e PBB-së rajonale.

Tab.7 **BARRA TATIMORE NDAJ PBB RAJONALE, 2015 - 2016** %

RENDITJA	Qarku	BARRA TATIMORE SIPAS PBB RAJONALE	
		2016	2015
1 (1)	Tiranë	29,4	27,4
2 (7)	Vlorë	26,2	25,3
3 (3)	Durrës	23,9	27,2
4 (6)	Korçë	21,7	26,3
5 (2)	Elbasan	21,3	27,3
6 (8)	Lezhë	21,0	24,0
7 (4)	Gjirokastrë	20,6	26,5
8 (11)	Fier	20,2	15,9
9 (10)	Shkodër	19,0	19,2
10 (12)	Berat	17,2	12,4
11 (5)	Dibër	14,3	26,4
12 (9)	Kukës	14,1	21,4

Burimi: INSTAT, MoF, Pushteti Vendor

Qarku i Shkodrës, megjithë spostimin me një vend në krahasim me vitin e kaluar përsëri ka një barrë tatimore më poshtë se barra tatimore gjithsej. Fieri, si një qark me një vlerë të shtuar dhe peshë në ekonominë e vendit me të paktën 13% të PBB-së ka një rritje të barrës tatimore,

që është një tregues i pagimit të taksave bazuar mbi vlerën e shtuar, po aq edhe nga rritja e performancës së administrimit fiskal.

Ndërkohë, Gjirokastra si një qark që ka një ndikim në sektorin e tregtisë kombëtare për shkakun se mbetet një portë e rëndësishme e importeve të jugut të vendit ka patur një lehtësim të barrës tatimore me 5.9 % më pak. Ulja e nivelit të barrës ka ardhur për arsye të uljes së pagesave të tatimeve mbi konsumin dhe kapitalin, për taksat kryesore të TVSH dhe tatim-fitimit.

Në këto qarqe edhe pse nuk ka patur politika tatimore specifike, shihet se administrimi i tatimeve nevojitet të ketë një vëmendje të veçantë për rritjen e bazës për secilin nga tatimet, por edhe cilësinë e vlerësimeve tatimore dhe nivelin e kontrollit ndaj evazionit tatimor. Formalizimi i ekonomisë dhe ulja e nivelit të evazionit për të gjithë këto qarqe është një problem ende i padresuar ashtu si është përcaktuar në objektivat kombëtare të antievazionit.

Qarqet me barrën tatimore më të lartë

Barra tatimore më e lartë mbetet edhe për vitin 2016 në qarkun e Tiranës me 29,4% të PBB-së rajonale duke shënuar edhe një rritje me 2% në raport me vitin e kaluar.

Vlora, me barrën tatimore që ka regjistruar për vitin 2016 përbën ndryshimin më të madh të vitit duke u renditur si qarku i dytë në Shqipëri me barrën tatimore më të lartë për vitin 2016. Një arsye kryesore është pagesa e tatimeve në mënyrë vullnetare me një rritje 14% në raport me vitin e mëparshëm. Po kështu edhe të ardhurat doganore dhe konsumi i qarkut ka një rritje që tregon se importet që kryhen për mallrat e konsumit mbetet brenda qarkut në më shumë se 30% të tyre. Nga ana tjetër porti i Vlorës ka rritur volumnin e qarkullimeve dhe është pika e dytë portuale më e madhe në Shqipëri, pas Durrësit.

Qarku i Durrësit mban të njëjtin pozicion si një vit më parë në renditjen e qarqeve sipas barrës tatimore. Por, barra tatimore e Durrësit është me një rënie prej 3.3%, për arsye të rritjes së PBB-së rajonale në një ritëm më të madh se pagesa e tatimeve dhe taksave.

Qarku i Elbasanit, Korçës dhe Lezhës kanë një rënie të barrës tatimore në krahasim me vitin e kaluar, respektivisht me 6%, 4.6% dhe 3% më pak. Megjithë rënien e nivelit të barrës tatimore, të tre këto qarqe mbajnë një barrë të lartë tatimore krahasuar me qarqet e tjera të vendit që kanë një barrë të ulët.

Të 6 qarqet që gjenden në vendet e para në tabelën 7, si dhe bashkitë që përfshihen brenda tyre konsiderohen me barrë tatimore më të lartë në vend, kurse Tirana dhe Vlora kanë një barrë tatimore që është mbi nivelin kombëtar të barrës tatimore.

III.

Barra Tatimore në Kosovë

Pesha e të ardhurave tatimore regjionale ndaj prodhimit të brendshëm në Kosovë

Në Kosovë barra tatimore ka ardhur në rritje nga viti në vit, por jo me ritme të shpejta. Barra tatimore e Kosovës peshon sa 23.5% e PBB-së kombëtare të vitit 2016. Peshën kryesore në buxhet e mban që nga fillimet e shtetit të ri të Kosovës nga regjioni i Prishtinës.

Tab.8 Barra tatimore ndaj PBB të Kosovës, 2016

RENDITJA	Regjioni	Të hyrat ndaj PBB %
1	Prishtinë	5,5%
2	Ferizaj	4,1%
3	Prizren	3,4%
4	Mitrovicë	2,9%
5	Gjilan	2,7%
6	Pejë	2,6%
7	Gjakovë	2,3%
TOTALI		23,5%

Burimi: ASK, MoF, Komunat

Për vitin 2016 kontributi i taksapaguesve të Prishtinës në buxhetin e qeverisë është sa 5.5% e PBB-së së Kosovës. Regjioni i Ferizaj mban vendin e dytë në peshën e kontributit fiskal në buxhet me një tregues

barre tatimore sa 4.1% e PBB-së.

Duke vijuar më tej me regjionin e Prizrenit, i cili ka mbajtur një barrë tatimore në buxhet sa 3.4% e PBB-së, mund të vërehet se gjithë regjionet e tjera kanë një peshë poshtë nivelit mesatar të barrës regjionale.

Më shumë se gjysma e barrës tatimore që është derdhur në formën e taksave dhe tatimeve në buxhet nga administrata tatimore dhe doganore kosovare i përket Prishtinës, Ferizajt dhe Prizrenit.

Nga analiza e renditjes së peshës së të ardhurave në PBB me peshën e banorëve ndaj popullsisë së vendit shikohet, se përveç tre qyteteve më të mëdhenj të Kosovës, të pozicionuar në tre vendet e para, të gjithë zonat e tjera kanë një peshë të ardhurash më të vogël se pesha e banorëve. Kjo mospërputhje ashtu si edhe në rastin e Shqipërisë spjegohet me përqëndrimin me shumicë të konsumit, industrisë e tregtisë në këto regjione.

Nga ana tjetër, edhe në Kosovë janë shfaqur vit pas viti probleme me performancën e administrimit fiskal. Treguesi më i plotë është rënia e efekteve të arkëtimeve nga TVSH, pas shkallëzimit të saj, edhe pse norma standarte u rrit me 2% për vitin 2016. Edhe pse pati këtë rritje në normën e TVSH nuk pati një administrim që të tregonte se kjo vlerë e shtuar duhet të shkonte direkt në buxhet, në mënyrë vullnetare dhe do ti shërbente rritjes së konsumit dhe rishpërndarjes të të ardhurave në popullatën e Kosovës.

Një faktor ndikues gjithashtu edhe në Kosovë lidhet me shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve për konsum, të cilat kanë një prirje të konsumohen jashtë zonës ku krijohen apo prodhohen drejt eksportit apo në zonat me dendësi popullore.

Shembull kuptimplotë gjithashtu është rasti i zonave ku nxirren pasuritë natyrore nëntokësore, me performancë të dobët fiskale në buxhet.

Regjionet me barrën tatimore më të ulët

Sipas raportit të tatimeve të paguara në vitin 2016 ndaj prodhimi të brendshëm të regjionit për vitin 2016, barra tatimore më e ulët është në regjionin e Gjakovës, Pejës dhe Gjilanit. Në këto regjione barra tatimore është jo më shumë se 11.3% e PBB-së respektive regjionale.

Në regjionet që mbajnë barrën më të ulët është Gjakova, e cila ka një mbizotërim të biznesit të vogël dhe atij mikro duke krijuar vështirësi për të paguar tatimet sipas ligjit në mënyrë vullnetare, por edhe për shkak të mungesës së kulturës fiskale për pagimin e taksave.

Arsyet e një barre tatimore të ulët gjenden më së shumti te kufizime të biznesit në këto zona, por edhe në një performancë që lidhet me probleme në administrimin në terren. Nga ana tjetër, informaliteti dhe korrupsioni kanë dhënë një ndikim në mbajtjen e barrës tatimore të paekspozuar dhe jotransparente për buxhetin.

Regjionet me barrën tatimore më të lartë

Barra tatimore më e lartë, në Kosovë është në regjionin e Prishtinës, që mban një barrë me të paktën 22.6% të PBB rajonale. Edhe për vetë strukturën e administrimit tatimor të Kosovës kjo barrë është më e lartë për shkak të përqëndrimit të aktiviteteve private dhe publike përreth këtij regjioni.

Edhe regjioni i Ferizaj, i cili gjendet në kufi me Maqedoninë mban një barrë tatimore që renditet në vendin e dytë në Kosovë me 17.5% të PBB-së regjionale. Regjioni i Prizrenit, që për nga rëndësia e ekonomisë kosovare mban një peshë me më shumë se 22% ka gjithashtu edhe një barrë tatimore që renditet në vend të tretë me 14.5% të PBB-së.

Tab.9 **BARRA TATIMORE NDAJ PBB REGIONALE, 2016**

RENDITJA	Regjioni	BARRA TATIMORE SIPAS PBB REGIONALE
1	Prishtinë	22,6%
2	Ferizaj	17,5%
3	Prizren	14,5%
4	Mitrovicë	12,3%
5	Gjilan	11,3%
6	Pejë	11,2%
7	Gjakovë	10,5%

Burimi: ASK, MoF, Komunat

Të gjashtë regjionet dhe komunat, që përfshihen brenda tyre konsiderohen me barrë tatimore më të ulët se barra tatimore e qarqeve të Shqipërisë, por edhe nën nivelin kombëtar të barrës tatimore.

Kështu nëse krahasojmë për nga ngjashmëria e pozicionit gjeografik dhe numri i popullsisë regjionin e Prishtinës me qarkun e Tiranës, krahasimi midis tyre nxjerr një barrë tatimore për takspaguesit e Tiranës 6.8 pikë përqind më të lartë. Po kështu edhe qarku u Kukësit që regjistron barrën më të ulët tatimore në Shqipëri është 11.8 pikë përqind më e lartë se barra tatimore e regjionit të Gjakovës.

Edhe pse krahasimi nuk mund të quhet korrekt gjithsesi është me vlerë për të parë se si ka ndikuar kjo barrë në zhvillimin ekonomik rajonal në të dy vendet, si dhe po ashtu a është shtuar investimi i huaj nsiur nga fakti se barra është më e ulët në Kosovë sesa në Shqipëri.

Në fakt, ashtu si u komentua edhe më lart barra tatimore nuk është elementi i vetëm që merret në konsideratë nga investorët. Por gjithsesi një barrë e ulët tregon se zhvillimi i kapaciteteve dhe teknologjia në përdorim janë ende në rrugën e tyre të forcimit dhe depërtimit më të madh në ekonomi.

IV.

Indeksi i Lirisë Fiskale 2017

Metodologjia

Dita e Lirise Fiskale llogaritet në bazë të raportit të të ardhurave tatimore për vitin fiskal me produktin e brendshëm bruto. Të ardhurat tatimore përfshijnë të gjithë llojet e taksave dhe tatimeve, detyrimet doganore, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Totali i të ardhurave tatimore llogaritet si një përqindje ndaj PBB-së. Raporti që rezulton shumëzohet me numrin e diteve të vitit (për vitin 2016 viti përmban 366 ditë). Numri që rezulton llogaritet si ditë të muajve duke filluar nga 1 Janari. Numri i ditëve të ndarë, sipas ditëve të çdo muaji vijues ndalon deri në ditën që plotësohet sipas muajit që i përkon. Ajo ditë që llogaritja ndalon konsiderohet si Dita e Lirisë Fiskale.

Kuptimi i kësaj dite lidhet me faktin se tatimpaguesit e vendit në këtë ditë kanë mbyllur llogaritë e pagimit të detyrimeve tatimore dhe nga kjo ditë e vitit e në vijim ata punojnë për veten e tyre, pa i patur asnjë detyrim tatimor shtetit.

Dita e Lirisë Fiskale në Ballkan, 2017

Nga llogaritja e ditëve që konsumohen në secilin shtet për të paguar barrën tatimore, nëse vlerësojmë dhe llogaritim të dhënat që deklaron secili nga vendet e Ballkanit, rezulton se në varësi të nivelit barrës tatimore ndaj PBB-së, Dita e Lirisë Fiskale në 2017 në Ballkan vjen në 17 prill 2017.

Ajo vjen fillimisht në Kosovë dhe mbaron me Greqinë.

Shqipëria e feston Ditën e Lirisë Fiskale shumë afër me Kosovën. Nisur nga data kur festohet Liria Fiskale secili kupton se sa i rëndon barra e buxhetit qytetarëve të vendit, por nga ana tjetër është indeksi që tregon se sa ditë të lira kanë bizneset dhe individët përgjatë vitit për të punuar për veten dhe familjet e tyre. Më poshtë gjendet Kalendari i Lirisë Fiskale 2017 për vendet e Ballkanit. Kalendari i Indeksit të Lirisë Fiskale 2017, përfshin 10 vendet e Ballkanit, për të cilët ishte i mundur edhe disponibiliteti dhe përpunimi i të dhënave statistikore për PBB dhe të ardhurat buxhetore.

SHTETI	KALENDARI DITES LIRISE FISKALE, 2017					
	Ditët	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj
KOSOVË	86			27		
SHQIPËRI	89			30		
MAQEDONI	93				3	
BULLGARI	104				14	
RUMANI	108				18	
SERBI	131					11
BOSNJË-HERCEGOVINË	138					18
MALI I ZI	139					19
KROACI	139					19
GREQI	148					28

Ndërsa, një vit më parë Dita e Lirisë Fiskale në Kosovë është festuar një ditë më herët, po kështu edhe Shqipëria që ndjek Kosovën e ka festuar Ditën e Lirisë Fiskale një ditë më herët se viti 2017.

Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri, 2017

Dita e Lirisë Fiskale, ashtu si edhe në gjithë vendet e tjera, edhe në Shqipëri është indeksi i lehtësimit të individit dhe biznesit nga barra e tatimeve dhe taksave. **Dita e Lirisë Fiskale për vitin 2017** është në ditën e **30-të të muajit Mars**.

Kjo datë u tregon gjithë shqiptarëve se sa u është dashur të punojnë për buxhetin e shtetit të tyre dhe u tregon se kjo periudhë ka zgjatur deri afër fundit të dhjetëditëshit të tretë të muajit të tretë të vitit. Pas kësaj periudhe, fitimet nga puna dhe kapitali i përkasin individit dhe pronarit të biznesit, pasi konsiderohet se buxheti ka arritur për vetëm tre muaj të marrë nga ata një pjesë të fitimeve prej punës apo kapitalit.

Por, sipas barrës tatimore të secilit qark, po ashtu nga llogaritja sipas kalendarit të vitit rezulton që Liria Fiskale të vijë në qytetet shqiptare në data të ndryshme të këtij viti.

DITA E LIRISË FISKALE 2017, PËR RAJONET TATIMORE NË SHQIPËRI

Nr.	Rajoni	KALENDARI DITËS LIRISË FISKALE, 2017				
		Ditë	Janar	Shkurt	Mars	Prill
1	Kukës	52		22		
2	Dibër	52		22		
3	Berat	63			4	
4	Shkodër	69			10	
5	Fier	74			15	
6	Gjirokastër	75			16	
7	Lezhë	76			17	
8	Elbasan	78			19	
9	Korçë	79			20	
10	Durrës	87			28	
11	Vlorë	96				6
12	Tiranë	107				17

Burimi: INSTAT, MeF, Pushteti Vendor

Liria Fiskale 2017 erdhi fillimisht në qarkun e Kukësit. Banorët e kësaj zone e festojnë këtë ditë afër fundit të Shkurtit 2017. Në ndryshim nga viti i kaluar, qarku i Beratti i cili provoi pari lirinë fiskale, në 2017 ky qark e feston ditën e lirisë fiskale në ditën e 4^{të} të muajit Mars 2017. Qarku i Dibrës e feston në po të njëjtën ditë ashtu si takspaguesit e qarkut të Kukësit, duke mbajtur të njëjtën pozicion edhe në renditjen e barrës fiskale si një vit më përpara.

Ndërkohë, pjesa më e madhe e qarqeve të vendit (8 qarqe) e festojnë Ditën e Lirisë Fiskale 2017 gjatë muajit Mars. Qarqet që e festojnë më vonë Ditën e Lirisë Fiskale 2017 janë Vlora dhe Tirana. Vlora e feston këtë ditë në fillim të muajit Prill 2017 dhe Tirana e feston këtë ditë në ditën e 17^{të} të muajit Prill 2017.

Pas kësaj date gjithë tatimpaguesit konsiderohen se janë zotë të fitimeve të tyre duke i përdorur ato fitime që ata përfitojnë (nga puna apo kapitali) për qëllime konsumi, kursimi, apo investimi).

Dita që feston gjithë Shqipëria nuk përkon me ditën e lirisë fiskale të secilit qark, pasi barra tatimore për Shqipërinë llogaritet si mestare e gjithë barrës tatimore të qarqeve të vendit.

Dita e Lirisë Fiskale në Kosovë 2017

Dita e Lirisë Fiskale në Kosovë mbërrin ditën e 27^{të} të muajit Mars 2017, apo tre ditë përpara se ajo të mbërrijë në Shqipëri. Kjo pararendje e festës së lirisë fiskale sqarohet nëpërmjet barrës tatimore që është më e ulët në Kosovë në krahasim me Shqipërinë.

DITA E LIRISË FISKALË 2017, PËR REGJONET TATIMORE NË KOSOVË					
Nr.	Rajoni	KALENDARI DITËS LIRISË FISKALË, 2017			
		Ditë	Janar	Shkurt	Mars
1	Gjakovë	38		7	
2	Pejë	41		10	
3	Gjilan	41		10	
4	Mitrovicë	45		14	
5	Prizren	53		22	
6	Ferizaj	64			5
7	Prishtinë	82			23

Burimi: ASK, MoF, Komunitat

Indeksi i Lirisë Fiskale për Kosovën llogaritet për herë të parë nga ALTAX.

Festa e Lirisë Fiskale në Kosovë për vitin 2017 mbërrin më shpejt në regjionin e Gjakovës në ditën e 7^{të} të Shkurtit 2017. Shumica e taksapaguesve që janë rezidentë të pesë regjioneve të Kosovës e festojnë Ditën e Lirisë Fiskale gjatë muajit Shkurt 2017.

Taksapaguesit në regjionin e Ferizaj dhe atë të Prishtinës e festojnë këtë ditë në muajin Mars 2017.

Në Ferizaj, taksapaguesit e festojnë ditën e Lirisë Fiskale 2017, në ditën e 5^{të} të Marsit dhe taksapaguesit e Prishtinës e festojnë lirinë fiskale në ditën e 23^{të} të Marsit 2017.

Përmbledhje

Barra ekonomike e një tatimi përfshin pagesat e kryera nga tatimpaguesi për buxhetin si dhe çdo vlerë ekonomike nga aktivitetet joeficiente si reagim ndaj barrës fiskale. Nisru nga fakti se barra tatimore është një e ardhur e deleguar nga tatimpaguesit për buxhetin e qeverisë, në rast se ajo nuk shpërndahet në mënyrë të barabartë do të jetë një kosto ekonomike që shoqërohet me shtrembërime të ekonomisë.

Një vend i fuqishëm ekonomik apo në rikuperim të zhvillimit ekonomik nuk bazohet vetëm në politikën tatimore bazuar te ndryshimi i normave, por në dallim nga sisteme të deformuara fiskale orienton barrën drejt atyre segmenteve të tatimpaguesve dhe qytetarëve që kanë mundësi më të mëdha për të përballuar pjesën kryesore të barrës tatimore. Ky detyrim ligjor, po aq edhe kombëtar është pjesë e përgjegjësisë së çdo biznesmeni dhe punonjësi fiskal, që përket me cilësinë e administrimit apo qeverisjes së taksave.

Barra tatimore në radhë të parë duhet të jetë qëllimi kryesor i transparencës së një qeverie.

Barra tatimore, e cila është publikuar vit pas viti në studimet që kemi kryer shikohet pikërisht si pjesë e transparencës tatimore. Në këtë kontekst, nëse përmbledhim atë që u prezantua deri më tani në material shikohet se barra tatimore ka patur ndryshime në tre vitet e fundit, duke kaluar në një rritje që tenton zhvendosjen e barrës nga tatimet indirekte te tatimet direkte.

Me peshën që mban Shqipëria dhe Kosova në PBB e rajonit është pak e ndjeshme në Ballkan. Por edhe pse PBB në Shqipëri apo Kosovë janë nga më të ulëtat e rajonit të Ballkanit, vërehet një rritje e barrës në 2016 krahasuar me 2015 e shoqëruar me rritje të interesit të investitorëve të huaj

Ky fakt spjegohet, jo prej rritjes/uljes së disa normave tatimore, por me rritjen e performancës fiskale dhe vullnetit për të luftuar informalitetin, veçanërisht në tregun e punës. Ky fakt duket te Indeksi i Ditës së lirisë Fiskale që në Shqipëri në vitin 2017 nuk vjen më herët se në çdo shtet tjetër ballkanik, ashtu si ka rezultuar në vitet e kaluara.

Investimet e Huaja Direkte neto në Shqipëri, me nivelin e hyrjeve sa 8.3% e PBB-së e renditin atë në vend të dytë në Ballkan për vitin 2016 duke treguar se efekti i barrës tatimore dhe shkallëve të ulëta nuk është ndikuesi primar në tërheqjen e investimeve. Por, edhe Kosova si një shtet ende në konsolidim dhe me treg të vogël ka një tregues të investimeve që e rendit atë në vendin e 5^{të} në Ballkan. Problemi i tregut të vogël në rastin e Malit të Zi nuk i ka kufizuar hyrjet e investimeve, por kryesisht ato janë nga Rusia dhe vende të tjera europiane të interesuara të investojnë në sektorin e turizmit malazez.

Treguesi i IHD neto na tregon se nëse harmonizohen me sukses shkallët tatimore me rritjen e kapaciteteve të administrimit dhe nëse forcohen kapacitetet zbatuese rregullatore dhe ulët korrupsioni, vendi do të rezultojë të jetë nxitës i flukseve të investimeve të huaja në vend. Ky konkluzion duhet të vlejë për Shqipërinë, Kosovën dhe secilin nga vendet e tjera ballkanike.

Barra tatimore e shpërndarë në rajonet e ndryshme të Shqipërisë, nëse ballafaqohet me burimet dhe kapacitetet në dispozicion dhe nëse ndërthuren në mënyrë më racionale me programet e qeverisë në shpërndarjen e investimeve dhe përgatitjen e kushteve për investitorët aty ku barra nuk është nxitëse, do të ndihmonte secilën bashki, që të mendonte më thellë mundësitë dhe mënyrat për tu integruar brenda modelit të rritjes ekonomike të vendit.

Rezultatet e analizës së të ardhurave tatimore të mbledhura me ndryshimet e politikës fiskale, përse preket kapitali dhe investimet, si dhe fuqia punëtore nuk tregojnë se kanë një lidhje direkte me çdo element të rritjes ekonomike.

Reduktimi i tatimit mbi pagën e punonjësve ka ndikuar në rritjen e numrit të përfshirë në tregun formal të punës duke ndikuar në fuqizimin e skemës së kontributeve, por nuk mund të konsiderohen se janë ende të lidhur me rritjen e produktivitetit.

Politika fiskale duhet të ketë lidhje të forta me zhvillimin e strukturës së ekonomisë, duke analizuar pa ndërprerje ndryshimet dhe zhvendosjet e ekonomisë nga njeri sektor te tjetri dhe ndikimet e tregjeve globale, që provuan për vitin 2015 ndikimin e tyre në barrën tatimore nëpërmjet çmimit të ulur të nënprodukteve të naftës, si dhe mineraleve.

Është barra tatimore ajo që duhet të bjerë në vëmendjen e të gjithë shoqërisë, qoftë sektor publik, por edhe sektori privat nxitjen që të ndryshojnë qasjen duke kërkuar një shpërndarje më të barabartë, ku të gjithë të ndihen kontribuesë dhe më pas përfituesë.

Një gjetje e fortë nga gjithë analiza është se jo të gjitha ndryshimet e normave tatimore mund të kenë efekt në rritjen ekonomike, të konsumit apo edhe të investimeve të huaja. Reformat që përmirësojnë nxitjen për investime, reduktojnë mbështetjet buxhetore për sektorë të ekonomisë publike, shmangin kolapset financiare dhe thellimin e boerxhit publik do të kenë një efekt të qartë dhe të dukshëm për gjithë qytetarët lidhur me ecurinë afatgjatë të ekonomisë.

SHTOJCA

BARRA E SHKALLEVE TATIMORE GJITHSEJ NE VENDET E BALLKANIT, 2015

ne %

RENDITJA	SHTETI	Barra e Shkalleve Tatimore			
		TOTALI	Tatim Fitimi	Tatimet mbi punen	Tatimet e tjera
1	MAQEDONI	12.9	10.9	0	2
2	KOSOVË	15.2	9.3	5.6	0.3
3	KROACI	20	0	18.8	1.2
4	MALI I ZI	21.6	8.1	12.8	0.7
5	BOSNJË-HERCEGOVINË	23.3	7.2	13.5	2.6
6	BULLGARI	27	5	20.2	1.8
7	SHQIPËRI	36.5	14.1	18.8	3.6
8	SERBI	39.7	16	20.2	3.5
9	RUMANI	42	10.9	30	1.1
10	GREQI	49.6	19.7	29.3	0.6

Burimi: WB, PwC

KRAHASIMI BARRES TATIMORE SIPAS ADMINISTRIMIT FISKAL ME NGARKESIN E SHKALLEVE TATIMORE SIPAS POLITIKES FISKALE

RENDITJA	SHTETET	BARRA TATIMORE NE 2015, sipas:	
		Shkalleve tatimore (%)	Administrimit tatimor (%)
1	MAQEDONI	12.9	26,2 (3)
2	KOSOVË	15.2	23,8 (1)
3	KROACI	20.0	38,0 (9)
4	MALI I ZI	21.6	37,5 (8)
5	BOSNJË-HERCEGOVINË	23.3	33,6 (6)
6	BULLGARI	27.0	29,2 (5)
7	SHQIPËRI	36.5	24,1 (2)
8	SERBI	39.7	35,3 (7)
9	RUMANI	42.0	28,2 (4)
10	GREQI	49.6	39,0 (10)

Burimi: WB, PwC

SHKALLET TATIMORE NE VENDET E BALLKANIT, 2016

ne %

Nr.	SHTETET	TVSH	TATIM FITIMI	TATIM MBI TE ARDHURAT PERSONALE	SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE		
					GJITHSEJ	PUNEDHE NESI	PUNEMARRESI
1	MAQEDONI	5,18	10	10	27	0	27
2	KOSOVË ¹	8.18	10	10	10	5	5
3	KROACI ²	5,13, 25	20	47.2	37.2	17.2	20
4	MALI I ZI	19	9	9	32.8	9.3	23.5
5	BOSNJË-HERCEGOVINË	17	10	10	41.5	10.5	31
6	BULLGARI ³	9,20	10	10	31.4	18.5	12.9
7	SHQIPËRI	20	5, 15	13,23	27.9	16.7	11.2
8	SERBI ⁴	20	15	15	37.8	17.9	19.9
9	RUMANI ⁵	5,9,20	16	16	54.5	38.45	16.05
10	GREQI ⁶	6,13,23	29	46	40.06	24.56	15.5

Burimi: WB, IMF, TE, PwC, EC, MoF

Shënim: Ndryshimet e shkallëve tatimore, 2016 me 2015

¹ Rritje TVSH me 2% dhe futja e shkallës së reduktuar të TVSH 8%

² Ulja e kontributeve të sigurimeve me 2%

³ Ulja e kontributeve të sigurimeve me 1,55%

⁴ Ulja e kontributeve të sigurimeve me 0,4%

⁵ Rritje TVSH me 4%

⁶ Rritje TATIM FITIMI me 3%. Ulja e kontributeve të sigurimeve me 1,95%

Lista e taksave vendore të qarkut Tiranë

- 1 Takse mbi pasurine e paluajtshme
- 2 Taksa mbi token Bujqesore
- 3 Toke truall
- 4 Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin (Taksa BV)
- 5 Taksa e fjetjes ne hotel
- 6 Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja
- 7 Taksa mbi kalimin te drejtes pronesise për pasurite e paluajt.
- 8 Taksa vjetore e mjeteve te perdorura
- 9 Taksa per zenien e hapësirave publike
- 10 Taksa e tabelës
- 11 Taksa e perkoheshme e lojrave te fatit dhe kazinove (per Tiranen)
- 12 Taksa e perkohëshme per infrastrukturen Arsimore (per Tiranen)
- 13 Tarifa e pastrimit
- 14 Tarifa e parkimit
- 15 Tarifa e shqyrtimit te kerkeses per leje per punime
- 16 Tarifa Urbanistikes (azhornim, planimetri, kontrolle etj)
- 17 Tarife dhenie licence tregtim karburanti +Lende djegese
- 18 Tarifa e sherbimit veterinar
- 19 Tarifa sherbimi te PMNZHSH
- 20 Tarifa vendore (NJA)

Lista e taksave vendore të qarkut Durrës dhe qarqeve të tjera në Shqipëri

1. Taksa mbi pasurine
2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël
3. Taksa e fjetjes në hotel
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme
6. Taksa e tabeles
7. Taksa e perkohshme e tregut
8. Tarifa e gjelberimit
9. Tarifa e pastrimit dhe e largimit të mbeturinave
10. Tarifa e plazheve private (për zonat bregdetare)
11. Tarife për leje për përdorim struktural
12. Tarifa e parkimit të automjeteve
13. Tarifa e ndricimit
14. Tarifa për zënien e hapësirës publike
15. Tarifat e shërbimit administrativ të Bashkisë
16. Tarifa për transportin publik
17. Tarifa e autorizimeve për tregtim karburanti
18. Tarifa e autorizimeve për qarkullimin në qytet
19. Tarifa për dhënie të lejeve për ushtrim veprimtarie
20. Tarifa e shërbimit veterinar
21. Tarifa e urbanistikës
22. Tarifa e institucioneve të Bashkisë
23. Taksa të administruara nga agjentët tatimor

REFERENCA

Ministria e Financave, Statistika Fiskale Janar - Dhjetor 2014, 2015, 2016

Ministria e Financave, Buletini Fiskal (ne tremujore)

Ministria e Financave, Treguesit e Borxhit, 2014, 2015, 2016

Ministria e Financave te Republikës se Kosovës, Treguesit makro dhe buxhetore 2014, 2015, 2016

ATK, Raportet vjetore 2015, 2016

Raportet e buxheteve komunale, Kosovë

Instituti GAP, Kosovë, Efektet e ligjit mbi Tatimin e Vlerës së shtuar, 2016

Raportet e buxheteve bashkive, 2016

INSTAT, ASK, PBB sipas qarqeve/regjioneve viti 2014, 2015, 2016

Tax card 2016 in Kosovo,

Kpmg.com.al

Eurostat, Tax to GDP Ratio, 2015

Greece Tax Card 2016, EuroFast

Paying taxes 2016, 2017, pwc.com


Tradingeconomics.com

World Bank, Statistical data, 2014, 2015, 2016

IMF, Country Reports 2016

Index of Tax Freedom Report, 2016, Heritage.org

Global Magazine Editions, 2016, 2017



Barra tatimore në Shqipëri, 2017

Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkan 2017

Barra tatimore në Shqipëri dhe Kosovë, sipas qarqeve/regjioneve

Barra tatimore mes vendeve të Ballkanit dhe investimet e huaja

Dokumente Fiskale Shqiptare

www.al-tax.org

altax@constultant.com

Mars 2017

Tiranë, Shqipëri